



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

V E N D I M

Nr. 5, Datë 07/01/2020

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 134, datë 23.10.2019, e z. I. Ç., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*aftësisë së kufizuar*”, nga ana e Znj. S. J., Drejtore pranë Shkollës 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, Elbasan dhe Zyrës Vendore Arsimore (ZVA) Elbasan.

Pas shqyrtimit përfundimtar të ankesës së mësipërme, Komisioneri¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, rezulton se ankuesi I. Ç. ka aplikuar tek portali “Mësues për Shqipërinë” 2019-2020 dhe është renditur i dyti në profilin “Histori”. Në vijim të këtij rezultati, Komisioni i Vlerësimit të Zyrës Vendore Arsimore Elbasan (ZVA Elbasan), në mbështetje të Udhëzimit nr. 13, datë 22.05.2019 “*Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e Portalit “Mësues për Shqipërinë”*”, në datën 21.09.2019, i ka ofruar ankuesit vendin e lirë të punës (provizor) pranë Shkollës 9-Vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, Elbasan.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Ankuesi sqaron se, pas nënshkrimit të procesverbaleve të pranimit për vendin e punës, është paraqitur në datën 24.09.2019, pranë Shkollës 9-Vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, Elbasan, për t’u prezantuar me drejtuesen e institucionit arsimor, stafin pedagogjik dhe për të marrë orarin mësimor. Z. I. Ç. pretendon se në datën 26.09.2019, është njoftuar nga titullarja e tij, që ZVA Elbasan nuk i ka dërguar ende formularin e tij të pranimit në vendin e punës, si dhe dosjen e tij personale. Në të njëjtën ditë, z. I. Ç. është paraqitur pranë ZVA Elbasan, ku i është komunikuar se dosja e tij ndodhet pranë DRAP Korçë, ndërkohë që formulari i pranimit duhej tërhequr nga vetë drejtoresha e shkollës, e cila duhet të paraqitej edhe për të nënshkruar kontratën individuale të punës me z. I. Ç.. Ankuesi ia ka komunikuar gjithshka titullares së tij, e cila sërish nuk është paraqitur pranë Zyrës Rajonale Arsimore Elbasan, për të kryer procedurat përkatëse. Zvarritjet institucionale kanë zgjatur edhe në ditët në vijim.

Referuar shkresës nr 645/1, datë 09.10.2019, së ZVA Elbasan drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë rezulton se gjatë periudhës së shkurtër, përgjatë se cilës ankuesi filloi punë pranë Shkollës 9-Vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, drejtoresha e shkollës, znj. S. J. ka patur shumë ankesa dhe shqetësime mbi aftësitë e tij profesionale dhe komunikimin e tij me nxënësit. Sërisht, sipas kësaj shkrese rezulton se, në datën 01.10.2019, Znj. S. J. ka përcjellë pranë ZRA Elbasan, shkresën zyrtare “Relacion”, të datës 01.10.2019, për mësuesin I. Ç., ku nënvizohen problemet e tij gjatë procesit mësimor, të cilat konsistojnë në kuptimin e tij me vështirësi nga ana e nxënësve, për shkak të problemeve që mësuesi shfaq gjatë artikulimit të fjalëve. Kjo pamundësi e mësuesit, sipas znj. S. J., ka sjellë probleme në menaxhimin e klasës, duke sjellë konfuzion dhe pamundësi për zhvillimin normal të procesit mësimor. Në këtë kontekst, Drejtoresha e shkollës ka parashtruar edhe shqetësimin e prindërve, se nxënësit tentojnë ta vënë në lojë mësuesin, duke prishur procesin mësimor. Bashkëlidhur shkresës së sipërpërmendur, drejtoresha e shkollës ka dërguar procesverbalin e nënshkruar nga prindërit e nxënësve të shkollës.

Në datën 02.10.2019, ankuesi është paraqitur pranë Zyrës Rajonale Arsimore Elbasan, ku i është komunikuar procesverbali i sipërpërmendur. Referuar këtij akti rezulton se Këshilli i Prindërve të kësaj shkolle e ka vlerësuar “dobët” performancën e mësuesit të ri dhe motivi i këtij vlerësimi konsiston në problemet e tij me shqiptimin. Për sa më sipër, rezulton se z. I. Ç. i është refuzuar punësimi, për shkak të problemit të tij me shqiptimin.

Ankuesi I. Ç. thekson faktin se problemi i tij me shqiptimin është i lindur dhe pavarësisht kësaj, një gjë e tillë nuk ka sjellë probleme, apo shqetësime gjatë procesit të mësimdhënies gjatë punës së tij si mësues, një vit më parë. Në këtë situatë, ankuesi pretendon se është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e znj. S. J., Drejtore pranë Shkollës 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, Elbasan dhe Zyrës Arsimore Elbasan.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A. Pas analizimit të ankesës nr. 134, datë 23.10.2019, e z. I. Ç., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B. Mbështetur në nenin 33, pika 7², të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua me shkresën nr. 1616/1, datë 25.10.2019, znj. S. J., Drejtore pranë Shkollës 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, Elbasan dhe Zyrës Arsimore Elbasan, ku kërkohet informacion, si më poshtë vijon:
- Praktika e ndjekur për z. I. Ç. (proçesverbali i pranimit, kontrata individuale e punës, kopje të akteve të Komisionit të Vlerësimit të Zyrës Vendore Arsimore Elbasan), si dhe kopje e dosjes personale të ankuesit;
 - Korrespondenca zyrtare ndërmjet Zyrës Vendore Arsimore Elbasan me Drejtoren e Shkollës 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, Elbasan dhe me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, mbi rastin e z. I. Ç.;
 - Proçedurat e ndërmarra në vijim nga ZVA Elbasan mbi rastin e z. I. Ç.;
 - Informacion mbi zgjidhjen që institucionet kompetente i kanë dhënë rastit të Z. I. Ç..
1. Znj. S. J., Drejtore pranë Shkollës 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, Elbasan nuk iu përgjigj shkresës nr.1616/1, datë 25.10.2019, së Komisionerit.
2. Në përgjigje të shkresës nr. 1616/1, datë 25.10.2019, së Komisionerit, Zyra Vendore Arsimore Elbasan dërgoi shkresën nr. 764, datë 05.11.2019, nëpërmjet së cilës sqarohet se z. I. Ç. është renditur në vendin e dytë në profilin “Histori”, në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2019-2020, ndërkohë që, për periudhën 2018–2019, është pozicionuar në vendin e 14.

² Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

Komisioni i Vlerësimit i DAR Elbasan, në bazë të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, *“Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”* i ka ofruar në datën 04.03.2019, vendin e lirë të punës në Shkollën Qerret, për të kryer zëvendësim të një mësueseje, që kishte marrë lejen e lindjes. Ankuesi punoi në këtë pozicion pune me kontratë pune të përkohshme deri në datën 18.06.2019.

Në vijim, Komisioni i Vlerësimit të ZVAP Elbasan, në mbështetje të Udhëzimit nr. 13, datë 22.05.2019, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, *“Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e Portalit “Mësues për Shqipërinë”*, në datën 21.09.2019, i ka ofruar z. I. Ç., vendin e lirë të punës (provizor) në shkollën 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, ofertë, e cila është pranuar nga aplikanti, i cili ka filluar punë si mësues historie pranë kësaj shkolle.

Drejtoresha e institucionit, znj. S. J. i është drejtuar Zyrës Vendore Arsimore Elbasan, me shkresën nr. 198/2, datë 24.09.2019, nëpërmjet së cilës ka përcjellë Vendimin nr. 42/1, datë 24.09.2019, *“Për emërim të përkohshëm në detyrë punonjësish mësuesorë”*. Vendimi në fjalë ishte nënshkruar vetëm nga ana e saj, por jo nga punëmarrësi. Njëkohësisht, titullarja e kësaj shkolle ka dërguar në adresë të Zyrës Vendore Arsimore Elbasan, Kontratën Individuale të Punës me afat të përcaktuar, nr. 198 Prot., datë 24.09.2019, e cila ishte e nënshkruar vetëm nga znj. S. J. dhe e pa nënshkruar nga z. I. Ç..

Në shkresën e ZVA Elbasan sqarohet gjithashtu se gjatë periudhës së shkurtër, kur ankuesi filloi punë, drejtoresha e shkollës, znj. S. J. pati shumë ankesa dhe shqetësime, në lidhje me aftësitë profesionale dhe komunikimin me nxënësit, të këtij mësuesi të ardhur nga Portali. Gjatë kësaj periudhe të shkurtër të punësimit të ankuesit, mësuesja nuk ka kryer asnjë orë kontrolli në orët mësimore të mësuesit I. Ç..

Në datën 01.10.2019, drejtoresha e shkollës, znj. S. J. ka përcjellë me shkresën zyrtare Relacionin e datës 01.10.2019, për mësuesin I. Ç., të cilën ZVAP Elbasan e ka protokolluar me nr. 621/1, datë 02.10.2019. Në këtë informacion nënvizohen problemet e këtij mësuesi gjatë procesit mësimor, të tilla si kuptimi me vështirësi nga ana e nxënësve, për shkak të problemeve që shfaq mësuesi gjatë artikulimit të fjalëve. Kjo pamundësi e mësuesit sjell problem në menaxhimin e klasës duke sjellë konfuzion dhe pamundësi për zhvillimin normal të procesit mësimor. Për këtë problem, prindërit janë shqetësuar, sepse nxënësit tentojnë ta vënë në lojë mësuesin, duke prishur procesin mësimor. Bashkëlidhur shkresës, drejtoresha e shkollës ka dërguar edhe procesverbalin e prindërve të shkollës, ku shprehej shqetësimi i tyre si pasojë e

problematikës së evidentuar në klasat, ku mësuesi I. Ç. jepte mësim. Ky procesverbal ishte i nënshkruar nga 7 prindër të nxënësve së kësaj shkolle.

Në këto kushte, ZVA Elbasan i ka komunikuar z. I. Ç., shkresat e përcjella nga drejtoria e shkollës për vlerësimin e punës së tij, si dhe procesverbalin e këshillit të prindërve të shkollës. Në vijim, drejtoresha e shkollës znj. S. J. dërgoi shkresën nr. 198/4, datë 02.10.2019, pranë ZVA Elbasan. Nëpërmjet kësaj shkrese përcillet Vendimi nr. 42/2, datë 02.10.2019 *“Për zgjidhje të marrëdhënieve të punës”* për ankuesin.

Në datën 04.10.2019, drejtoresha e shkollës dërgoi pranë ZVA Elbasan, një informacion me shkrim, i cili është protokolluar pranë Zyrës Vendore Arsimore Elbasan me nr. 638/1, datë 07.10.2019. Ndërkohë që, në datën 21.10.2019, një përfaqësues i prindërve të shkollës 9-vjeçare *“Seit Pepa”*, Vidhas, paraqitet pranë Zyrës Vendore Arsimore Elbasan. Në takim e realizuar me përfaqësuesin e prindërve të kësaj shkolle u mbajt procesverbali, i cili mban numrin e protokollit nr. 695/1, datë 21.10.2019. Në këtë procesverbal, përfaqësuesi i prindërve të nxënësve të shkollës ngre shqetësimin për mbarëvajtjen e procesit mësimor, kur jepte mësim mësuesi I. Ç..

ZVA Elbasan, duke patur parasysh renditjen e mësuesit në portalin *“Mësues për Shqipërinë”*, i ka sugjeruar ankuesit, të paraqesë një kërkesë për t’u punësuar si mësues ndihmës, për të pasur mundësinë e sistemimit sa më parë në punë. Në datën 23.10.2019, Z. I. Ç. depoziton kërkesën e tij për punësim, si mësues ndihmës, pranë zyrës arsimore, për të patur mundësinë e sistemimit sa më parë në punë.

Në datën 23.10.2019, Z. I. Ç. ka sjellë në ZVA Elbasan, kërkesën për të punuar si mësues ndihmës në institucionet arsimore parauniversitare. Në vijim, me shkresën nr. 713, datë 24.10.2019, ZVA Elbasan e njofton Znj. S. J. për fillimin e procedurës disiplinore, ndërkohë që me Vendimin nr. 69/1, datë 28.10.2019, të ZVA Elbasan, i jepet masa disiplinore *“vërejtje”*. Vendimi i sipërpërmendur u dërgua zyrtarisht pranë DRAP Korçë dhe pranë MASR.

Komisioni i Vlerësimit të ZVA Elbasan i ka ofruar në datën 04.11.2019, Z. I. Ç., vendin e lirë të punës provizor, si mësues ndihmës në Shkollën 9- vjeçare *“Avdyl Paralloi”*, Elbasan. Ankuesi, pasi e shqyrtoi ofertën, në datën 05.11.2019, e refuzoi atë. ZVA Elbasan e informoi KMD-në, se në vijim do t’i ofrojë z. I. Ç., mundësi të tjera punësimi, sipas kërkesave të institucioneve arsimore.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës nr. 134, datë 23.10.2019, e z. I. Ç., Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni, i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Në ankesën nr. 134, datë 23.10.2019, e z. I. Ç., pretendohet diskriminim për shkak të *“aftësisë së kufizuar”*, nga ana e Znj. S. J., Drejtore pranë Shkollës 9-vjeçare *“Seit Pepa”*, Vidhas, Elbasan dhe Zyrës Vendore Arsimore (ZVA) Elbasan.

I. Pretendimi i pare, i ankuesit, për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, drejtohet ndaj Znj. S. J., Drejtore pranë Shkollës 9-vjeçare *“Seit Pepa”*, Vidhas, Elbasan.

Referuar akteve të depozituara në cilësinë e provës, rezulton se z. I. Ç. është renditur në vendin e dytë në profilin *“Histori”*, në portalin *“Mësues për Shqipërinë”* 2019-2020. Mbështetur në parashikimin e pikës 2, të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, *“Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”*, ku parashikohet shprehimisht: *“Shpallja e vendeve të lira të punës, konkurrimi, renditja e kandidatëve për mësues, si dhe pranimi në një vend të lirë pune realizohen nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”, si dhe pikës 5, të Kreut 4, të këtij Udhëzimi, ku citohet: “Kandidati, i cili në renditjen e përgjithshme është renditur me numrin më të madh të pikëve, ka të drejtën e zgjedhjes për vendin e lirë të punës dhe është i detyruar të konfirmojë në ZVAP brenda 24 orëve nëpërmjet adresës elektronike.”*, ZVAP Elbasan i ofroi Z. I. Ç. pozicionin vakant të punës (provizor) në Shkollën 9-vjeçare *“Seit Pepa”*, Vidhas, ofertë, e cila është pranuar nga aplikanti, i cili ka filluar punë si mësues historie pranë kësaj shkolle.

Në vijim, Drejtorja e Shkollës 9-vjeçare *“Seit Pepa”*, Vidhas, Elbasan ka miratuar dhe nënshkruar Vendimin nr. 42/1, datë 24.09.2019 *“Për emërim të përkohshëm në punë punonjësish mësimorë”*, nëpërmjet së cilit përcaktohet:

“1. Z. I. Ç., me arsim të lartë profil histori-gjeografi, emërohet mësues i lëndës histori dhe gjeografi në shkollën 9-vjeçare “Seit Pepa”, Elbasan, nga data 24/09/2019 deri në datën 24/10/2019.

2. Z. I. Ç. emërohet përkohësisht në këtë vend pune deri në datën 24/10/2017.

3. Marrëdhëniet financiare fillojnë më datë 24/09/2019.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ka vlerë juridike vetëm i shoqëruar me “Kontratën e Punës me afat të përcaktuar”.

Në fund të Vendimit të sipërpërmendur figuron emri i ankuesit si bashkëpunues me Znj. S. J., ndërkohë që nga verifikimi i drejtpërdrejtë i këtij akti rezulton se nënshkrimi i tij mungon, pasi atij nuk i është dhënë asnjëherë, ky akt, për nënshkrim, nga ana e titullares së institucionit arsimor. Vendimi i mësipërm i është dërguar Zyrës Arsimore Vendore Elbasan, vetëm me nënshkrimin e Drejtores së Shkollës 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, por pa nënshkrimin e z. I. Ç..

Njëkohësisht, i njëjti fakt konstatohet edhe tek Kontrata Individuale e Punës nr. 198, datë 24.09.2019, së ankuesit, e cila është e nënshkruar vetëm nga titullarja e Shkollës 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, ndërkohë që firma e z. I. Ç. sërisht mungon, pasi nuk i është vënë në dispozicion për ta lexuar e nënshkruar.

Në vijim, në datën 01.10.2019, Drejtoresha e shkollës, znj. S. J. ka përcjellë pranë ZVAP Elbasan, Relacionin e datës 01.10.2019, për mësuesin I. Ç., ku citohet: *“Mësuesi Ilir Copja i lëndës histori-gjeografi i ardhur nga Portali dhe paraqitur në shkollën tonë me dt. 24.09.019 shfaq problem në artikullimin e fjalëve. Nxënësit e kuptojnë me vështirësi. Kjo pamundësi e mësuesit sjell problem me menaxhimin e klasës. Prindërit janë të shqetësuar, sepse mësuesi i mëparshëm ka pasur problem të ngjashëm dhe ditë pas dite ka humbur menaxhimin e klasës duke sjellë konfuzion dhe pamundësi për zhvillimin normal të mësimit. Ata shprehen se mësuesin fëmijët tentojnë ta imitojnë, ta vënë në lojë edhe pse kanë zhvilluar pak mësim. Tendanca është që rastet problemore të vijnë duke u shtuar. Nisur nga kjo situatë si dhe numrin e madh të nxënësve për klasë mendojmë se me gjithë ndihmën, që i është dhënë nga kolegët, situata do të jetë e vështirë për t’u menaxhuar në ditët në vijim.”*

Relacioni i sipërpërmendur, shoqërohet me Aktin *“Proçesverbal i opinionit të Këshillit të Prindërve për mësuesin I. Ç., profili Histori – Gjeografi, Shkolla “Seit Pepa”*” Referuar këtij akti rezulton se në datën 30.09.2019, ora 14:00, është mbledhur Këshilli i Prindërve në Shkollën 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas. Qëllimi i këtij takimi ka qenë dhënia e opinionit për mësuesin I. Ç., lidhur me performancën e tij në proçesin mësimor-edukativ, sjelljen dhe etikën në institucionin arsimor³. Referuar aktit në fjalë rezulton se opinionin i prindërve për mësuesin I. Ç., është cilësuar si i dobët, që është edhe vlerësimi minimal.

³ Referuar shprehimisht Proçesverbalit të datës 30.09.2019, mbi takimin e Këshillit të Prindërve.

Nga analizimi i procesverbalit të Këshillit të Prindërve, Komisioneri konstatoi se ky akt nuk përmbante asnjë arsyetim apo justifikim, që të sqaronte këtë vlerësim. Në këtë akt, thjesht kryhej vlerësimi për një mësues të sapo emëruar në detyrë, i cili kishte vetëm 6 ditë që kishte filluar të jepte mësim pranë Shkollës 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, Elbasan. Procesverbali është i nënshkruar nga 8 prindër, të cilët sikurse rezulton nga përmbajtja e këtij akti, nuk japin asnjë shpjegim, mbi arsyet e vlerësimit, që kanë dhënë për z. I. Ç.. Ndërkohë që, sqarimet mbi problematikën e z. I. Ç., jepen vetëm në relacionin e Drejtoreshës së Shkollës.

Menjëherë pas relacionit të datës 01.10.2019, Drejtoresha e Shkollës 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, Elbasan, ka nënshkruar Vendimin nr. 42/2, datë 02.10.2019 *“Për zgjidhje të marrëdhënies së punës”* me z. I. Ç.. Këtë vendim, titullarja e këtij institucioni arsimor ia drejton Zyrës Arsimore Vendore Elbasan. Pas analizimit të këtij vendimi, Komisioneri konstatoi se ky akt nuk përmban asnjë motivacion për zgjidhjen e kontratës individuale të punës me z. I. Ç.. Ndërkohë që, në datën 04.10.2019, znj. S. J., Drejtore pranë Shkollës 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, Elbasan dërgon sërish pranë ZVA Elbasan, një Relacion tjetër mbi z. I. Ç., ku sqaron se nuk ka patur asnjë konflikt me të, si dhe shprehet mbi ankuesin si vijon: *“...Ankesa e parë më erdhi nga nxënësit, të cilët u shprehën se nuk e kuptojnë. Mësuesi flet, por nuk kuptohet, kur shpjegon. Nxënësit në bankat në fund të klasës nuk e dëgjojnë. Mësuesi lodhet dhe bën pauza të gjata. Në klasën e tetë është rrëzuar. Mësuesit e tjerë janë përpjekur t’i japin ndihmën e tyre duke u folur nxënësve në lidhje me sjelljen në klasë. Më pas ankesat vijuan nga prindërit, të cilët të shqetësuar nga fjalët e fëmijëve reagojnë. Kjo pamundësi e mësuesit sjell problem me menaxhimin e klasës. Mësuesi i mëparshëm ka pasur problem të ngjashme dhe ditë pas dite ka humbur menaxhimin e klasës duke sjellë konfuzion dhe pamundësi për zhvillimin normal të mësimin..... Ata shprehën se nuk janë kompetentë për të gjykuar mbi saktësinë e informacionit që jep mësuesi në mësim, por këmbëngulin se një mësues duhet të flasë qartë që nxënësit ta kuptojnë kur shpjegon. Ata ndjehen të diskriminuar për faktin se janë në fshat dhe i sjellin mësues të tillë. Fëmijët tanë kanë të drejtë të mësojnë si të gjithë. Shkova në ZVA për të informuar për rastin dhe i thashë prindërve se do t’i kthej përgjigje. Mësuesi vjen nga portal nuk kemi çfarë të bëjmë më thanë. Prindërit nëse nuk e duan të ndjekin procedurën për largim dhe mësuesi do të presë renditjen për një vend tjetër pune dhe ne do të sjellim një mësues tjetër për ta zëvendësuar.”*

Në pikën 1 të nenit 60, të ligjit nr. 69/2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”* (i ndryshuar) parashikohet shprehimisht: *“1. Në institucionin arsimor publik, përfshirë dhe atë parashkollor, pranimi dhe emërimi i mësuesit në një vend të lirë pune mbështetet në parimin e meritës dhe të drejtën për zgjedhjen e institucionit arsimor. Emërimi i mësuesit bëhet nga drejtori i institucionit arsimor, sipas renditjes në portalin “Mësues për*

Shqipërinë". Procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune, si dhe administrimi i portalit "Mësues për Shqipërinë" përcaktohen me udhëzim të ministrit." Në pikën 2, të të njëjtit nen, parashikohet: "Drejtori i institucionit publik largon mësuesin nga institucioni për: a) shkelje të dispozitave të Kodit të Punës, të këtij ligji e të akteve të tjera nënligjore; b) shkelje të etikës e të sjelljes në institucion; c) mos arritje të nxënësve, të përcaktuara në mënyrë objektive, si testimet e drejtorisë së institucionit ose të njësisë arsimore vendore, rezultatet në provimet kombëtare dhe vlerësimi i Inspektoratit Shtetëror të Arsimit. 3. Drejtori i institucionit arsimor publik vendos largimin e tij pas konsultimit me komisionin e përmendur në pikën 1 të këtij neni, sipas procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit."

Referuar Vendimit nr. 42/2, datë 02.10.2019 "Për zgjidhje të marrëdhënies së punës" për z. I. Ç., ai nuk përmban asnjë motivacion që lidhet me parashikimet e pikës 2, të nenit 60, të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar).

Njëkohësisht, vlen të përmendet fakti se mbështetur në pikat 4 e 5, të nenin 58, të Urdhërit Nr. 343, datë 19.8.2013, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, "Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar" parashikohet shprehimisht se: "4. Drejtuesit e institucionit arsimor: a) vëzhgojnë orë mësimore, orë të kujdestarisë, mbledhje të ekipeve lëndore, takime të mësuesve kujdestarë me prindërit, veprimtari jashtëkurrikulare; b) organizojnë zhvillimin e pyetësorëve me nxënës dhe prindër. 5. Drejtuesit zhvillojnë miniteste, si bazë për bisedën profesionale me mësuesit dhe organizimin e ndihmës për ta.". Gjatë hetimit administrative rezultoi se drejtoresha e Shkollës 9-vjeçare "Seit Pepa", Vidhas, Elbasan nuk ka ndërmarrë asnjë nga hapat e parashikuar më sipër për të hetuar çështjen në fjalë.

Mbështetur në analizën e akteve të mësipërme, Komisioneri konstaton se edhe mësuesi i emëruar para Z. I. Ç., për të njëjtin pozicion pune, ka pësuar fatin e ankuesit, si rrjedhim i të njëjtit problem me artikulin.

Për sa më sipër, KMD çmon se veprimet e ndërmarra nga Znj. S. J., Drejtore pranë Shkollës 9-vjeçare "Seit Pepa", Vidhas, janë totalisht tendencioze ndaj z. I. Ç., që në fillim të marrëdhënieve të punës së ankuesit në Shkollën 9-vjeçare "Seit Pepa", Vidhas, Elbasan. Nga shqyrtimi i akteve të mësipërme rezulton se nuk ka asnjë ankesë me shkrim të prindërve të nxënësve të kësaj shkolle mbi ankuesin. Gjithashtu, vlen të theksohet fakti se në Proçesverbalin e Këshillit të Prindërve të mbajtur në takimin e datës 30.09.2019, nuk rezulton asnjë arsyetim i këtij Këshilli mbi vlerësimin e kryer ndaj këtij mësuesi. Arsyetimet dhe justifikimet përkatëse rezultojnë të jenë dhënë vetëm në aktet e hartuara nga titullarja, e cila nuk ka kryer asnjë monitorim të drejtpërdrejtë në orët e mësimit të zhvilluar nga mësuesi I. Ç., si dhe asnjë testim të nxënësve, të

cilët marrin mësim nga ky mësuës, por është mbështetur vetëm në argumente të pambështetura në asnjë dokument. Njëkohësisht, Komisioneri gjykon se një element rëndues për pozitën e titullarës së këtij institucioni arsimor është edhe fakti i mosbashkëpunimit me institucionin e KMD-së, ndërkohë që ndodhet në cilësinë e subjektit kundër së cilit drejtohet ankesa. Neni 82, pikat 2 dhe 3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar)⁴ ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në rastin konkret znj. S. J., Drejtore pranë Shkollës 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, Elbasan, e cila nuk i ka kthyer përgjigje shkresës nr.1616/1, datë 25.10.2019, së Komisionerit.

Në interpretim të pikës 1, të nenit 7 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku parashikohet: *1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim*”, Komisioneri gjykon se z. I. Ç. është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë e disfavorizues nga znj. S. J., Drejtore pranë Shkollës 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas.

II. Pretendimi i dytë, i ankuesit, për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, drejtohet ndaj Zyrës Arsimore Vendore Elbasan.

Në vijim të momentit kur çështja e Z. I. Ç. u bë mediatike, nëpërmjet Emisionit Investigativ “Stop”, erdhën reagimet e para nga ana e ZVA Elbasan. Nëpërmjet Urdhërit nr. 66/1, datë 22.10.2019, të Drejtores së Zyrës Arsimore Vendore Elbasan, është ngritur Komisioni Disiplinor pranë këtij institucioni, si dhe është filluar proçedimi disiplinor ndaj Znj. S. J.⁵. Në shkresën e dërguar nga ZVA Elbasan theksohet fakti se në vijim ndaj znj. S. J., Drejtore pranë Shkollës 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas është marrë masa disiplinore “vërejtje”.

⁴Neni 82, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) parashikon: “2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj. 3. Në mënyrë që të mbështesin pretendimet e tyre, palët mund t’i bashkëlidhin kërkesës për fillimin e proçedurës administrative dokumente ose fakte të ndryshme.”

⁵Znj. S. J. është njoftuar për fillimin e proçedurës disiplinore, nëpërmjet shkresës nr. 713, datë 24.10.2019, të ZVA Elbasan;

Komisioni i Vlerësimit të ZVA Elbasan i ka ofruar në datën 04.11.2019, Z. I. Ç., vendin e lirë të punës provizor, si mësues ndihmës në Shkollën 9- vjeçare “Avdyl Paralloi”, Elbasan, i cili është refuzuar nga ankuesi. ZVA Elbasan e ka bërë me dije KMD-në, se do t’i ofrojë në vijim z. I. Ç., mundësi të tjera punësimi, sipas kërkesave të institucioneve arsimore.

Për sa më sipër, në interpretim të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, Komisioneri çmon se ZVA Elbasan nuk e ka ekspozuar ankuesin ndaj një trajtimi të padrejtë e disfavorizues.

A. Shkaku i mbrojtur.

Ankuesi I. Ç. ka pretenduar diskriminim për shkak të “*aftësisë së kufizuar*” nga ana e Znj. S. J., Drejtore pranë Shkollës 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, Elbasan dhe Zyrës Vendore Arsimore (ZVA) Elbasan.

1. “*Aftësia e kufizuar*” është një prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*”.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të “*aftësisë së kufizuar*”, Komisioneri gjykon se, në referencë të pikës 20, të Komentit të Përgjithshëm Nr. 6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, të Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, **diskriminim per shkak të aftësisë së kufizuar janë ndër të tjera edhe rastet kur personat supozohen se kanë aftësi të kufizuar.**

Komisioneri gjykon se ankuesi ndodhet në situatën e mësipërme, ku është prezumuar se është me aftësi të kufizuar.

B. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

Në ankesën nr. 134, datë 23.10.2019, e z. I. Ç., pretendohet diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, nga ana e znj. S. J., Drejtore pranë Shkollës 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, Elbasan dhe Zyrës Vendore Arsimore (ZVA) Elbasan.

Z. I. Ç., pavarësisht faktit se nuk disponon një Vendim të KMCAP Elbasan, që të vërtetojë aftësinë e kufizuar, sërish ai është perceptuar, si individ me aftësi të kufizuara, nga Drejtoresha e Shkollës 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, Elbasan, por edhe nga Zyra Vendore Arsimore Elbasan. Ndjesinë e të perceptuarit si individ me aftësi të kufizuar e ka patur edhe ankuesi, lidhur me mënyrën se si është përshkruar në relacionet e Drejtoreshës.

Sikurse është përmendur edhe më sipër, në relacionin e datës 04.10.2019, drejtoresha e kësaj shkolle është shprehur si vijon: *“Mësuesi flet, por nuk kuptohet, kur shpjegon. Nxënësit në bankat në fund të klasës nuk e dëgjojnë. Mësuesi lodhet dhe bën pauza të gjata. Në klasën e tetë është rrëzuar..... Ata shprehen se nuk janë kompetentë për të gjykuar mbi saktësinë e informacionit që jep mësuesi në mësim, por këmbëngulin se një mësues duhet të flasë qartë që nxënësit ta kuptojnë kur shpjegon. Ata ndjehen të diskriminuar për faktin se janë në një fshat dhe i sjellin mësues të tillë.”*

Në pikën 20, të Komentit të Përgjithshëm Nr. 6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, të Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, (miratuar në Sesionin e 19 (14 Shkurt – 9 mars 2018), të këtij Komiteti) citohet: *“Diskriminimi “për shkak të aftësisë së kufizuar” mund të jetë kundër personave që aktualisht kanë një aftësi të kufizuar, personave që kanë patur dikur një aftësi të kufizuar, personave që kanë predispozicion për aftësi të kufizuar në të ardhmen, individëve, të cilët prezumohen se kanë aftësi të kufizuar.....”. Arsyeja për shtrirjen e gjerë të parashikimit të Nenit 5 konsiston në zhdukjen dhe luftimin e të gjitha situatave dhe sjelljeve diskriminuese, që lidhen me aftësinë e kufizuar.”*

Në bazë të parashikimit të sipërpërmendur rezulton se konsiderohen të diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar, jo vetëm ata individë që janë të tillë, në bazë të akteve përkatëse të komisioneve për përcaktimin e aftësisë së kufizuar, por edhe ata individë, të cilët perceptohen apo prezumohen si të tillë, si pasojë e problematikave, që paraqesin fizikisht. Në këtë kontekst, legjislacioni përkatës, që mbron të drejtën e individëve me aftësi të kufizuar për t’u mbrojtur nga diskriminimi, vlen njëjloj edhe për ata individë që presupozohen si të tillë dhe disfavorizohen e trajtohen padrejtësisht për këtë shkak të prezumuar.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri krijoi bindjen e arsyeshme se z. I. Ç. është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe disfavorizuese si nga Drejtoresha e Shkollës 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, Elbasan, e cila e ka ekspozuar ankuesin ndaj një qendrimi tepër diskriminues, që reflektohet në mënyrë evidente në veprimet e saj, kundër tij. Për sa kohë që, Z. I. Ç. rezultoi fitues në “Portalin Mësues për Shqipërinë”, që njihet ligjërisht, si mënyra e punësimit në pozicionin e mësuesit në një profil të caktuar, asnjë titullar institucioni arsimor nuk mund të vërë në diskutim aftësitë e tij, për të cilat ai ka rezultuar fitues.

Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” siguron të drejtën e çdo individit për t’u mbrojtur nga diskriminimi në fushën e punësimit, për të gjitha shkaqet e përcaktuara në nenin 1, të këtij ligji. Në nenin 12, të LMD, parashikohet shprehimisht:

“1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim, që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:

a) shpalljen e vendeve të lira të punës;

b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve;

c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës;

ç) anëtarësinë në sindikata dhe mundësinë për të përfituar nga lehtësitë që siguron kjo anëtarësi.

2. Ndalohet çdo lloj shqetësimi, përfshirë edhe shqetësimin seksual, nga punëdhënësi përkundrejt një punëmarrësi ose një kërkuesi për punë ose midis punëmarrësve.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se z. I. Ç. është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar nga znj. S. J., Drejtore pranë Shkollës 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, Elbasan.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 12 - 14, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e diskriminimit të z. I. Ç., për shkak të aftësisë së kufizuar, nga znj. S. J., Drejtore pranë Shkollës 9-vjeçare “Seit Pepa”, Vidhas, Elbasan.
2. Konstatimin e mosdiskriminimit të z. I. Ç., për shkakun e pretenduar në ankesë, nga Zyra Vendore Arsimore (ZVA) Elbasan.
3. ZVA Elbasan të marrë masat e nevojshme, për punësimin e z. I. Ç., si dhe të njoftojë KMD-në mbi rezultatet përkatëse, brenda 30 ditëve nga dita e marrjes dijeni mbi këtë vendim.
4. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha – punësim
Shkak – aftësia e kufizuar